



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.09.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 04.09.2019.
2. Shqyrtimi në parim i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Klotilda Bushka, Almira Xhembulla. Amra Barova, Edlira Bode, Adelina Rista, Arben Kamami, Roland Xhelilaj, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Koçi Tahiri, Ervis Meço, Edmond Stojku dhe Halil Jakimi.

Mungon:

Ilir Pendavinji.

Të ftuar:

Ogerta Manastirliu - Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Vjollca Braho - Kryeinspektore e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor

Etiola Kola - Këshilltare

Orjola Shahaj - Këshilltare

Vojsava Gjoliku - Përgjegjëse e Sektorit

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi - Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë me këtë rend dite: miratimi i procesverbalit të datës 04.09.2019, si edhe shqyrtimi në parim i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.06.2008 "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut", të ndryshuar". Ne jemi komisioni përgjegjës.

Të pranishme në komision janë: zonja Ogerta Manastirliu, ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zonja Vjollca Braho, kryeinspektore e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, zonja Etiola Kola, këshilltare, zonja Orjola Shahaj, këshilltare, si edhe zonja Vojsava Gjoliku, përgjegjëse Sektori.

Pa humbur kohë, do të flasim për rëndësinë e informatikës kaq të gjerë të jodit, pasi jemi një vend endemik. Ndryshimet janë të dukshme, por prevalenca e gushës apo e strumës në Shqipëri mbetet ende e lartë. Ky ligj bën eliminimin e plotë të pamjaftueshmërisë jodike në vitet e ardhshme.

Fjala është për ju, zonja Ministre!

Ogerta Manastirliu - Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Vijmë përpara jush me një propozim në kuadër të ligjit nr. 9942, datë 26.06.2008 "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut", duke synuar që të propozojmë disa ndryshime dhe shtesa në ligjin ekzistues për të përmirësuar të gjitha masat që ndërmarrim në funksion të eliminimit të pamjaftueshmërisë jodike në shëndetin e popullatës. Pamjaftueshmëria jodike dhe shqetësimet që ajo shkakton në shëndetin e popullatës, lidhen kryesisht me shëndetin e fëmijëve dhe të grave shtatzëna, por edhe të të rriturve përgjatë ciklit të jetës së tyre, ku problematika të theksuara qoftë me shëndetit, siç e thatë strumën, gushën siç njihet ndryshe, shihen te fëmijët në raport me shëndetin fizik të tyre, por edhe atë mendor edhe te gratë shtatzëna, ku pamjaftueshmëria jodike mund të sjellë dhe problematika në lindjet parakohe apo në vdekjet e fëmijëve, që mund të vijnë nga këto problematika lidhur me deficiencën jodike.

OBSH-ja dhe UNICEF-i në të gjitha rekomandimet e tyre, që janë rekomandime të forta, lidhen me elementin e rëndësishëm të jodizimit universal të kripës për konsum

njerëzor, shtazor dhe në industrinë ushqimore. Një nga prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka qenë dhe mbetet elementi i pamjaftueshmërisë jodike në popullatën shqiptare, gjë që reflektohet edhe në strategjitë e miratuara sektoriale.

Duke iu referuar edhe disa ndryshimeve ligjore që kanë ndodhur në vitin 2013 në thelb kanë prekur rolet e institucioneve aktuale. Kemi vërejtur se ka disa problematika që zbërthehen në boshllëqe, kur flasim për kontrollin, monitorimin e fortifikimit të kripës në vendin tonë. Prandaj ka lindur nevoja që të propozojmë disa ndryshime të fokusuara në komponentet e inspektimit, të monitorimit të kripës së jodizuar për rolin e institucioneve që përfshihen në to, për përcaktimin e institucioneve që do të bëjnë monitorimin, inspektimin e kripës, ndarjen e qartë të kompetencave në procesin e monitorimit dhe dhënien e detyrave çdo institucioni, duke shmangur mbivendosjen dhe duke plotësuar boshllëqet që ekzistojnë aktualisht. Ne në këtë kuadër duam dhe synojmë që nëpërmjet këtyre ndryshimeve ligjore të arrijmë disa objektiva të rëndësishëm. E para, të kontrollojmë në masën 100% kripën ushqimore të prodhuar nga stabilimentet e jodizimit të kripës në vendin tonë, të kontrollojmë në masën 100% kripën ushqimore të importuar në vendin tonë përmes marrjes në kohë të mostrave dhe analizave laboratorike për nivelin e jodit në momentin që futet në territor në pikat doganore të Republikës së Shqipërisë, si dhe të monitorojmë në masën 100% të territorit të vendit nivelin e përmbajtjes së jodit në kripën ushqimore, bazuar në zbatimin e një metodologjie kampionimi, përfaqësuese e të dhënave në nivel kombëtar, sipas një planifikimi vjetor të monitorimit nga strukturat vartëse të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, qoftë në nivel kombëtar, qoftë në nivel rajonal.

Ajo çfarë është e rëndësishme dhe ajo çfarë propozojmë sot lidhet me ndarjen e përgjegjësisë, të funksioneve dhe të kompetencave të strukturave, të cilat do të realizojnë monitorimin dhe inspektimin. Po ashtu e rëndësishme dhe përcaktohet në këtë ligj është se vendoset një sistem i ri, që është sistemi i gjurmueshmërisë. Sot kripa në vendin tonë, kripa e jodizuar fortifikohet në stabilimentet vendase. Ne plotësojmë nevojën e kripës së jodizuar, kryesisht rreth 75-80% nga kripa e prodhuar dhe e fortifikuar në vend. Prandaj detyra jonë, mundësia që do të na japin ndryshimet ligjore janë që të ndahen proceset e monitorimit, të kontrollit dhe të kemi një arkiv të gjurmueshmërisë, që në momentin e prodhimit, e fortifikimit, w vendosjes në treg dhe riinspektimit, pasi dihet që edhe pas fortifikimit kripa mund të humbë nivelet e jodit, kur rri në treg për një kohë të gjatë dhe duhet të rifutet për jodizim.

Përpos ndryshimeve që kanë lidhje me terminologjinë e përshtatur në këtë projektligj, i rëndësishëm është roli që marrin operatorët rajonale dhe njësitë vendore të kujdesit shëndetësor Kombëtar në nivel qarku dhe në nivel bashkie në raport me kontrollin e kripës së jodizuar dhe matjen e niveleve të jodit në kripë gjatë gjithë procesit, që nga momenti i prodhimit deri te kthimi i kripës nëpërmjet laboratorëve dhe metodologjive standarde që këto laboratorë në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor aktualisht realizohen.

Nga ana tjetër, vendosim që kontrolli i kripës së jodizuar, për paracaktimin e nivelit të jodit në mostrën e kësaj kripe, të realizohet nëpërmjet analizave laboratorike standarde në zbatim të legjislacionit në fuqi, por edhe sipas rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe UNICEF-it.

Po ashtu, ky ligj, në ndryshimet që propozojmë, vendos që kripa e jodizuar për rastet e kripës që importohet (në raport shumë më të vogël se sa e kemi pasur në vitin 2012) do t'i nënshtrohet kontrollit në pikat doganore nga disa autoritete, sigurisht, duke i dhënë secilit kompetencat që kanë bazuar në ligjin në fuqi, që janë autoritetet doganore, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe drejtoritë rajonale apo vendore që kryejnë analizimin e mostrave të kripës që importohet në vend.

Është shumë e rëndësishme kjo ndarje funksionesh dhe dhënia e përgjegjësisë dhe kompetencave, pikërisht për të siguruar të gjithë ciklin e monitorimit dhe kontrollit të kripës së jodizuar, pasi deri më sot ka pasur paqartësi dhe vetëm inspektimet që janë kryer nga Inspektorati Shëndetësor nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar dhe për të bashkëpunuar në gjithë ciklin e kontrollit dhe monitorimit të kripës së jodizuar duke qenë se është një element shumë i rëndësishëm, i cili ndikon direkt në shëndetin e popullatës.

Duke qenë se është ky alert i ngritur, edhe pse Shqipëria është në nivele të mira, përsëri vlerësohet se (nga studimi demografiko-shëndetësor që ne kemi realizuar) ka një tendencë uljeje të përdorimit të kripës së jodizuar nga familjet.

Kjo do të thotë se ajo çka duhet të bëjmë ne është të forcojmë instrumentet tona të kontrollit dhe të monitorimit, në mënyrë që kripa që del në treg, të jetë një kripë e jodizuar sipas standardeve, të cilat lejohen me ligj dhe që përcaktohen në bazë të rekomandimeve të OBSH-së dhe organizma të tjerë.

Për sa i përket kripës së jodizuar të importit, në këtë projektligj ne vendosim që importuesi është i detyruar të kryejë analizën laboratorike për nivelin e jodit në momentin e futjes së kripës në pikën doganore. Shpenzimet për marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave laboratorike të nevojshme për kontrollin e kripës së jodizuar do të përballohen

pikërisht nga subjekte që importojnë kripën, kjo edhe për vendosur një standard të ri për sa i përket certifikimit, analizave dhe më pas edhe verifikimit, inspektimit, që kryejnë subjektet apo institucionet e tjera, siç është Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.

Nga ana tjetër, për sa i përket monitorimit të kripës së jodizuar, verifikimi, qoftë në pikat e shitjes me shumicë apo me pakicë do të realizohet nga njësitë e kujdesit shëndetësor, sipas një sistemi të monitorimit periodik, raportimi për të cilët do të jetë mbi baza mujore dhe prodhuesit e kripës së jodizuar në vend dhe importuesit e saj do të jenë përgjegjësit kryesor për cilësinë e kripës së jodizuar.

E vendosim këtu, pasi masat administrative që do të merren në raport me moszbatimin e këtij ligji do të jenë, gjithashtu, drastike dhe nuk do të ketë tolerancë për ata që nuk i zbatojnë këto norma të vendosura për pasurimin e kripës me jod.

Një element risi i propozuar në këtë ligj, që e përmenda pak më parë dhe që besoj se përmirëson të gjithë procesin që nga momenti i prodhimit, i pasurimit, i tregtimit dhe i importit, gjithashtu, është sistemi i gjurmueshmërisë që ne vendosim dhe që përfshihet në këtë ligj.

Operatori i biznesit ushqimor do të krijojë dhe do të mbajë informacionin e nevojshëm për gjurmueshmërinë në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit, jonizimit të kripës dhe shpërndarjes së saj, si dhe do të ketë si kusht për të plotësuar:

- mbajtjen e të dhënave mbi identitetin e çdo subjekti tregtar apo personi juridik apo fizik, nga i cili operatori i biznesit ushqimor është furnizuar me kripë;
- identitetin e çdo subjekti tregtar, të cilin operatori i biznesit ushqimor e ka furnizuar me kripë.

Ndërkohë, operatori i biznesit ushqimor do të ruajë të dhënat për jo më pak se tri vjet dhe do të sigurojë që këto të dhëna t'i jepen Ministrisë së Shëndetësisë dhe Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor.

Këto janë pikat kryesore që unë doja t'i ndaja me ju në raport me përmirësimet që i bëhen këtij ligji dhe që synojnë kontrollin 100% dhe eliminimin e pamjaftueshmërisë jodike në vendin tonë.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, zonja Ministre!

A ka pyetje nga deputetët?

Atëherë kam unë një pyetje. A është e ndarë mirë, se shpeshherë në terren shohim se ka përplasje midis Inspektoratit të Ushqimit, AKU-së, dhe Inspektoratit Shëndetësor, se kanë të bëjnë të dy me ushqimet?

Në lidhje me fortifikimin e ushqimeve me kripë të jodizuar, pavarësisht se duam të fusim kripën që të përdoret nga njerëzit, ajo që ne duam faktikisht të shëndeti publik është që tendenca e endemisë së gushës të ulet drejt zeros. Duam që njerëzit ta marrin kripën nëpërmjet ushqimeve.

Në këtë kontekst, nuk e di si është parashikuar, por ne kërkojmë që të gjitha ushqimet, dhe OBSH-ja ka një listë ushqimesh, mund të fortifikohen me kripë të jonizuar. Pra, të mos u lihet dëshirës së njerëzve në tavolinë, por ta marrin edhe fëmijët, edhe gratë.

Di se para ca vitesh, Instituti i Shëndetit Publik dhe UNICEF-i kanë pasur një survejancë sentinel për gratë shtatzëna endemike në disa zona malore të Shqipërisë, siç është Luma, Dibra, Mokra apo Gramshi e të tjera, duke bërë analizat e urinës, për të kapur sasinë e jodit. Sipas meje, kjo është shumë problem në shëndetin publik. Kostoja që paguan shërbimi shëndetësor, qoftë në drejtim të invaliditetit, që vjen nga pamjaftueshmëria apo zhvillimi i pakët mendor, qoftë nga struma apo trajtimi i tyre, është shumë e madhe.

Besoj se futja në fortifikim e kripës së jodizuar do ta zgjidhë përfundimisht dhe njëherë e mirë këtë sëmundje endemike në Shqipëri.

Ju faleminderit!

Mund të mblidhen edhe pyetje të tjera. Po, Klodi.

Klodiana Spahiu – Faleminderit, kryetar!

Së pari do të doja t'ju falënderoja që ky projektligj ka ardhur në parlament. Doja të falënderoja edhe UNICEF-in, që ka qenë shumë bashkëpunues në lidhje me këtë projektligj.

Në fakt, do të thosha se ky është një nga projektligjet shumë të rëndësishme, që ka të bëjë me shëndetin, kryesisht me shëndetin mendor të fëmijëve, por edhe të grave shtatzëna. Ligji është i vitit 2008. Ne bëjmë disa ndryshime, të cilat vinë si rrjedhojë e miratimeve që kemi bërë në 2013-ën në lidhje me inspektoriatin.

Pa dyshim, ne do të jemi më kërkuar në lidhje me monitorimin dhe zbatimin e rregullores së re në lidhje me kontrollin që do t'i bëhet të gjitha institucioneve që janë në Shqipëri, të cilat kanë mundësi të bëjnë jodifikimin e kripës, si dhe të asaj që vjen nga jashtë, që importohet.

Megjithatë, unë do të ndalesha në dy pika kryesore. Ka studime të OBSH-së, të cilat vërtetojnë se edhe sot, pavarësisht kontrolleve që bëhen në vendet europiane, 50 % e fëmijëve

lindin me probleme të defiçencës jodike, probleme që pasqyrohen në koeficientin intelektual ose në zhvillimin e trurit të fëmijëve.

Pra, edhe pse kontrollet atje janë bërë të vazhdueshme, dhe besoj se monitorimi dhe kontrolli është në nivele të larta, përsëri ekzistojnë këto mungesa të jodit, sidomos te fëmijët.

A ka ndonjë mundësi tjetër? A ka studime, që tregojnë se edhe jonizimi i bukës është një variant shumë i mirë për të eliminuar defiçencën jodike? A kemi ndonjë parashikim, se mund ta bëjmë një gjë të tillë? Sepse është e vërtetë, këto masa që ju sapo përmendët, padyshim do ta rrisin kontrollin që do të bëhet nga autoritetet, por do të rrisin edhe shkallën e monitorimit që do të bëhet nga drejtoritë e shëndetit publik. Por besoj se ka edhe rajone që u përmendën këtu, të cilat janë në Veri ose në zona të thella, në të cilët ndjekja e grave shtatzëna është vërtet shumë e vështirë. A kemi ndonjë mundësi, që të mund ta realizojmë një gjë të tillë të paktën vetëm për gratë shtatzëna, duke ditur pasojat që ndodhin te fëmijët e lindur nga nëna me defiçencë jodike. Ose ta nisim me një sistem pilot, që t'i bëhet një analizë e thjeshtë, që është TSH-shi, që vlerëson nëse nëna ka apo jo pamjaftueshmëri jodike.

Kjo bëhet vetëm meqenëse ka zona endemike, të cilat e kanë më të zhvilluar këtë mungesë. Jo në të gjitha zonat, sepse e kuptoj se është gjë e papërballueshme. Kjo është një mënyrë.

Pastaj, do të thosha edhe diçka tjetër. Nga viti 2013 e deri sot ka pasur një mangësi, kjo edhe sipas raportimit që keni bërë ju në këtë kontroll. Ka qenë disi e paqartë nëse kontrolli duhej bërë nga autoriteti apo nga ASHR-ja.

Përsëri jam pak skeptike në lidhje me frenimin e këtij fenomeni. Kjo sepse, kur në vendet europiane ka qenë e vështirë të bëhej e të mos realizohej 100 %, por prapë ka pasur lindje të fëmijëve me mungesë jodike, them se do të jetë pak e vështirë edhe nga ana jonë. Ose le të gjejmë një mënyrë tjetër, bashkë me kripën e jodizuar, për ta kapërcyer këtë pengesën e mungesës së jodit. Thjesht po diskutonim me kryetarin. ...ndoshta është një mënyrë më e thjeshtë dhe më e lirë, vetëm për gratë shtatzëna.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Xhelilaj – Si të prezantohemi? Akoma këtu jemi ne, te prezantimi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E tha kryetari emrin. Faleminderit, zonja Ministre për shpjegimet!

Faleminderit, kryetar!

Në fakt, ndryshimet në këtë ligj shumë të rëndësishëm, që vjen sot për t'u diskutuar në komision, kryesisht janë te përcaktimi i saktë i detyrave që kanë institucionet përkatëse në inspektim e në monitorim.

Duke qenë se ligji është i rëndësishëm, duke qenë se ligji ekzistues ka pas përcaktuar që përgjegjësinë kryesore për cilësinë e prodhimit të kripës së jodizuar e ka prodhuesi, ju zonja Ministre theksuat se 75 % deri në 80 % prodhohet në vend. Sipas meje, kjo përbën një mundësi që ne të kemi një kontroll efektiv për prodhimin e kripës së jodizuar.

Këtu desha të pyesja e të merrja një informacion shtesë nga ju. Këto ndryshime, të cilat prekin vetëm ndarjen e kompetencave të institucioneve që bëjnë inspektim-monitorimin, a ndikojnë drejtpërdrejt te prodhuesit e kripës, për të përmirësuar a për të pasur vëmendje? Patjetër, efekt shumë të rëndësishëm ka sistemi i gjurmueshmërisë, por vetëm në këto dy pika qëndron përgjegjësia, apo deri këtu shkon detyrimi për përmirësimin e cilësisë së tyre të punës? Apo këto janë të harmonizuara edhe me forma të tjera? Unë mendoj se ka rëndësi, për arsye se përqindjet bëjnë të mundur që ajo sasi që ngelet nga importi të jetë shumë më lehtë të kontrollohet edhe nga institucionet përkatëse.

Faleminderit!

Almira Xhembulla – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, dua të falënderoj ministren për prezantimin e projektligjit dhe për angazhimin që sjellin projektligje, të cilat adresojnë realisht prioritetet dhe problematikat kryesore që lidhen me shëndetin e popullatës!

Pa diskutim, pamjaftueshmëria jodike, ashtu siç u theksua edhe nga kolegët, është një problem. Siç e tha edhe zoti kryetar, ka zona endemike dhe unë përfaqësoj një ndër këto zona.

Duke marr shkas edhe nga ajo çfarë thanë kolegët, si do të ndikojnë pozitivisht projektligje, nëpërmjet ashpërsimit të masave administrative apo qartësimit të kompetencave dhe detyrave që kanë aktorët e përfshirë, duke pasur parasysh që kemi edhe përfaqësuesen e inspektoratit këtu? Domethënë, mbase edhe të dyja, por si e shikoni ju? Duke pasur parasysh që ky projektligj do të ndikojë edhe në produktet që sillni nga importi, por në shumicën e rasteve kripa që prodhohet në vend. Për momentin, ku e shikoni ju që nuk kemi arritur të ndikojmë dhe ta kontrollojmë ashtu siç duhet? Kemi më shumë problematika në kontrollin e produkteve të importuara, apo në prodhimet vendase? Mbase nuk e di, por mund të fusim, ashtu siç e propozoi kolegja Spahiu, që për gratë shtatzënë në zonat endemike analizat e

detyrueshme për të përcaktuar nivelin e jodit. Nuk e di se si janë eksperiencat në vendet e tjera.

Faleminderit!

Enver Roshi – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Atëherë, vazhdojmë me përgjigjet.

Ogerta Manastirliu – Faleminderit!

Më lejoni të jap disa përgjigje sqaruese për çështjet që u ngritën.

Në fakt, të gjitha janë shumë të rëndësishme. Dua të ndalem te momenti shumë i rëndësishëm i bashkëpunimit, që do të kemi me Ministrinë e Bujqësisë për sa i përket listës së të gjitha produkteve ushqimore, të cilat duhet të kenë kripë të jodizuar, pra të përpunohen nëpërmjet kripës së jodizuar. Do të jetë një udhëzim i përbashkët me ministrin e Bujqësisë që do të përcaktojë pikërisht prodhimin e ushqimeve që duhet të përmbajnë kripë të jodizuar. Pa dyshim, kjo do të përmirësojë nivelin e marrjes së kripës, sepse ka metoda dhe mënyra alternative të marrjes së jodit.

Së pari, nëpërmjet jodizimit të kripës.

Gjithashtu, jodizimi i miellit, pra fortifikimi i miellit. Ne bashkë me OBSH-në dhe me Ministrinë e Bujqësisë e kemi marrë këtë si iniciativë; kemi bërë një bisedë paraprake dhe besoj se shumë shpejt do të kemi një bashkëpunim konkret për sa i përket fortifikimit të miellit. Të rëndësishëm për projektligjin që jemi duke diskutuar janë instrumentet që ky ligj përcakton; ndarjen e kompetencave që përcakton në strukturat, të cilat do të monitorojnë dhe do të kontrollojnë kripën e jodizuar që në momentet e prodhimit. Ashtu siç edhe u përmend këtu, është e rëndësishme që ky projektligj nëpërmjet masave dhe përgjegjësi që përcakton për strukturat shtetërore, rrit cilësinë për i përket prodhimit të kripës së jodizuar në vend. Pa dyshim, është një element i shtuar kontrolli dhe monitorimi nëpërmjet testeve dhe analizave laboratorike, të cilat do të jenë jo sipas një sistemi sporadik të kontrollit, por sipas një sistemi gjurmueshmërie me raportim mbi baza periodike, në mënyrë që i gjithë tregu i prodhimit të kripës të kontrollohet, pra jo vetëm ai që prodhon, por edhe aty kur tregtohet në pikat e tregtimit me shumicë dhe pakicë, për të vlerësuar pikërisht këto elemente, të cilat janë shumë të rëndësishme për shëndetin e qytetarëve.

Së fundi Ministria e Shëndetësisë ka ndërmarrë me mbështetjen e UNICEF-it një projekt për të bërë një studim në nivel kombëtar për jodurin për të bërë një verifikim në nivel kombëtar te gratë shtatzëna se si është niveli i jodit për të vlerësuar më pas në rang kombëtar se ku qëndrojmë ne në raport me vendet e tjera. Patjetër kjo bëhet për të vendosur ato piketa

dhe për të identifikuar zona të përcaktuara të vendit tonë, të cilat do të kenë nevojë për të pasur një vëmendje të shtuar pikërisht të planeve tona të promocionit, por edhe të kontrollit rigoroz, që duhet të ndodhë në terren pikërisht për të garantuar që kripa të jetë e jodizuar, sipas niveleve të përcaktuara në rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Enver Roshi – Faleminderit, zonja Ministre!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Dua të them se e vlerësoj shumë raportimin që bëri Ministria e Shëndetësisë. Ky është një ndryshim i duhur, që ka një impakt shumë të madh në shëndetin publik në Shqipëri. Mjafton t'ju përmend një shifër që gjatë punës sime si mjek në Lumë të Kukësit, në vitet 1986-1987, 80% e fëmijëve vuanin nga gusha. Ishte një gushë e dukshme. Gjithsesi, edhe pse është bërë shumë punë dhe ka shumë arritje, ky ligj vjen në një kohë të përshtatshme dhe jep një ndihmë shumë të madhe në shëndetin publik. Kostoja që paguan shteti për pamjaftueshmërinë mendore të fëmijëve apo të të rriturve, invaliditetin, për operacione apo për gjëra të tjera është shumë e madhe. Kjo do të bëjë që të ketë impakt të madh jo vetëm shëndetësor, por edhe financiar në vend. Ajo që na intereson në shumë si mjekë dhe profesionistë është marrësi, njerëzit vetë. Pra, krahas edukimit, promocionit që duhet të ketë Instituti i Shëndetit Publik apo të gjitha drejtoritë rajonale për të ndërgjegjësuar popullsinë për të marrë kripën e jodizuar, ne duhet të kemi një plan masash që fortifikimi i ushqimeve, jo vetëm i bukës, por edhe i ushqimeve të tjera të bëhet që njerëzit ta marrin domosdoshmërisht jodin nëpërmjet ushqimeve. Kjo është ajo që ne duam të arrijmë. Ne duam që Ministria e Shëndetësisë bashkë me Ministrinë e Bujqësisë të ketë listën e ushqimeve, ku OBSH-ja ka bërë një listë ushqimesh, që të gjitha këto ushqime të jenë të fortifikuara nga kripa e jodizuar. Ne, së shpejti, në bashkëpunim me ju do të kalojmë edhe fortifikimin e miellit apo bukës për hekurin, që është i nevojshëm për të ulur nivelin e anemisë në popullatën shqiptare.

Këtu e mbyllim shqyrtimin e kësaj çështjeje. Duke ju falënderuar, mirë u takofshin në takimet e ardhshme!

Ftoj anëtarët e komisionit të votojnë në parim ndryshimet në projektligj. Kush është dakord?

Miratohet.

Pika tjetër e rendit të ditës është miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar. A jeni dakord me procesverbalin?

Miratohet.

Faleminderit!

Kolegë, kërkohet mendim edhe nga anëtarët e komisionit tonë për Planin e Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimit të Raportit të Komisionit European për Shqipërinë për vitin 2019, i cili do t'ju përcillet me email. Kush ka mendime lidhur me këtë, mund t'i dërgoj me email.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të flas me Klodin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në datën 10 tetor në seancë plenare kemi dy ligje: atë për jodin dhe atë për pajisjet mjekësore. Ne do të kërkojmë që ligji për pajisjet mjekësore të shtyhet një javë më vonë, pra në datën 10 tetor të kalojë në seancë plenare vetëm ligjin për jodin.

Nesër kishim parashikuar një seancë dëgjimore për vaksinimin, ku ftuam ministren për të raportuar. Ministrja nuk është dhe kërkon që seancën ta zhvillojmë pas një jave, në datën 25 shtator, por deputetët e maxhorancës nuk janë, sepse kanë angazhime të tjera. Si do ta planifikojmë këtë seancë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne nuk e dimë, ju e dini më mirë, sepse ju keni eksperiencë.

Mirë atëherë, e mbyllim mbledhjen.

MBYLLET MBLEDHJA